



Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, nenit 10 pika 1 dhe 2 e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për transparencë në komuna dhe nenit 7 të Rregullores Komunale për Transparencë NR.03/2019, Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Zyrën për Informim, bën:

NJOFTIMIN

PËR

TAKIMIN E PARË PUBLIK TË KRYETARIT

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara, se Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi organizon takimin e parë publik me qytetarë për punën e tij në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2022.

Takimi publik me qytetarë do të mbahet më datë: 23.06.2022 (e enjte), në orën 13:00, në sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec. Në këtë takim do të keni mundësi të njiheni për punën e qeverisë komunale në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2022 dhe zhvillimet aktuale në Komunë.

Po ashtu qytetarët pjesëmarrës në takim mund t'i bëjnë pyetje dhe komente ekzekutivit të Komunës për të gjitha temat të cilat atyre ju interesojnë.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri më datë: 22.06.2022 në ora 16:00, në emailat: ali.morina@rks-gov.net dhe blerta.gashi@rks-gov.net.

Jeni të mirëpritur!

